



Fondi Shqiptar në mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja

START-UP

Fondi ka për qëllim të mbështesë bizneset e sapo krijuara "Start-Up" në Shqipëri, nëpërmjet subvencionimit financiar të drejtpërdrejtë duke përmirësuar klimën dhe kushtet operuese të tyre, me synim krijimin e bazave për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, si dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

SEKTORËT QË MBULON FONDI

Sektorët Prodhues dhe të Shërbimit
Sektorin e Industrisë së Lehtë
Sektorin e Turizmit

Fushën e Kërkimit dhe të Zhvillimit
Procesin e Agropërpunimit
Fushën e Dizenjimit, Modelimit, Artizanatit



PËRFITUES TË FONDIT

- Bizneset e klasifikuara si mikro dhe të vogla sipas ligjit Nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", të ndryshuar;
- Përfitojnë bizneset nga 0-2 vjet të regjistruara në QKB;
- Të jenë në gjendje të financojnë 50% të të gjitha kostove të projektit në fazën e aplikimit;
- Të kenë selinë ose vendin kryesor të prodhimit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- Të kenë në objektin e veprimtarisë një nga sektorët që mbulon fondi;
- Të prodhojnë produkte ose të ofrojnë shërbime që tregtohen apo që mund të tregtohen në nivel kombëtar ose ndërkom-bëtar;
- Të jenë sipërmarrje në kërkim të tregjeve;
- Të krijojnë minimalisht 1-3 vende të reja pune brenda 12 muajve nga momenti i përfitimit të fondit;
- Të kenë staf të aftë për zbatimin e duhur dhe në kohë të aktiviteteve të propozuara.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Kërkesa paraqitet pranë AIDA-s nga vetë kërkuesi apo çdo person i autorizuar prej tij.

Formulari i aplikimit mund të shkarkohet nga faqja e internetit të AIDA-s www.aida.gov.al.

Punonjësi i AIDA-s asiston aplikantin në plotësimin e formularit të aplikimit.

APLIKANTI DUHET TË DORËZOHË DOKUMENTACIONIN E MËPOSHTËM:

- Aktin e regjistrimit të ndërmarrjes sipas legjislacionit në fuqi (ekstrakti i QKB-së);
- Pasqyrat financiare të vitit të fundit të ndërmarrjes;
- Buxhetin e projektit;
- Projektin (Plan Biznesin) e propozuar;
- Vetëdeklarimin që ndërmarrja është e aftë për zbatimin e duhur dhe në kohë të aktiviteteve të propozuara;
- Dokumentin e identifikimit të personit që paraqet kërkesën në emër të ndërmarrjes;
- Autorizimin që vërteton se personi që paraqet kërkesën në emër të ndërmarrjes nuk është titullari i saj, por vepron në emër të saj.



FINANCIMI

- Një ndërmarrje mund të përfitojë maksimalisht 500.000 (pesëqind mijë) lekë për projekt;
- Skema mbulon 70% të shpenzimeve të miratuara brenda limitit të mësipërm;
- Pagesa e fondit të përfituar bëhet 50% në fillim të projektit dhe 50% në përfundim të projektit, kundrejt faturës/faturave e cila/të cilat vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera të cilat do të dorëzohen në përfundim të projektit;
- Fondi nuk mund të jepet më tepër se një herë për të njëjtën sipërmarrje;
- Pranimi i aplikimeve është subjekt i disponueshmërisë së fondeve dhe mund të pezullohet në çdo kohë në rast se fondet kanë mbaruar;
- AIDA në faqen e saj të internetit do të publikojë gjendjen e disponueshmërisë së Fondit.

Aplikimet do të vlerësohen nga Komisioni i Aprovimit të Grantit (KAG), i cili do të mblidhet sipas aplikimeve të paraqitura. Vendimi për miratimin ose refuzimin e një aplikimi bazohet vetëm mbi dokumentat e paraqitura. KAG gjatë shqyrtimit të çdo aplikimi merr në konsideratë kriteret e paraqitura në rregulloren e këtij Fondi. Pas vlerësimit të aplikimit, brenda 48 orëve, aplikuesit njoftohen për vendimin e marrë nga KAG. Aplikantët e refuzuar do të informohen në lidhje me shkaqet e refuzimit.

SHPENZIMET E MBULUESHME

Skema rimburson shpenzimet për aktivitetet e mëposhtme:

- Investime në pajisje dhe teknologji për nxitjen e prodhimit/shërbimit;
- Promovim, publikim dhe hartim materialesh promovuese;
- Përshtatje produkti duke përfshirë ambalazhim dhe etiketim;
- Kualifikim dhe trajnim për rritjen e aftësive sipërmarrëse;
- Krijim faqesh në internet dhe zhvillim të tregtisë elektronike;
- Pjesëmarrje në panair ose ekspozitë brenda apo jashtë shtetit, si vizitor apo ekspozues.

SHPENZIMET E PAMBULUESHME

Shpenzimet të cilat nuk rimbursohen:

- Shpenzime të lindura para datës së nënshkrimit të kontratës së grantit;
- Shpenzime tregtare, përfshirë përfaqësimin;
- Zbavitje dhe dhurata;
- Shpenzime të ndërmarrjeve për stafin e tyre;
- Shpenzime administrative;
- Shpenzime të lindura në vazhdimësi prej strukturave dhe detyrimeve ekzistuese;
- Çdo aktivitet i paligjshëm.

PËRGJEGJËSITË E PËRFITUESVE

PËR TË SIGURUAR RIMBURSIMIN, APLIKANTËT E SUKSESSHËM DUHET TË:

- Respektojnë në mënyrë rigoroze dhe integrale të gjitha deklaratat e shprehura dhe angazhimet e marra;
- Paraqesin tek Menaxheri i Skemës një raport në lidhje me përfundimin e projektit, si dhe çdo dokument të nevojshëm për të bërë të mundur kryerjen e pagesës;
- Vënë në dispozicion të AIDA-s çdo informacion që lidhet me zbatimin e projektit;
- Pranojnë çdo lloj monitorimi, vlerësimi dhe/apo auditimi.
- Përfundojnë projektin brenda kohës së parashikuar në marrëveshje.



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Adresa:
Blv. "Dëshmorët e Kombit",
Kryeministria, Kati III, Tiranë

website: www.aida.gov.al
email: info@aida.gov.al
Tel: +355 042 251001